

STATUT

i

Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “LAKEVIEW CABINS” SH.P.K.

Sot, më datë 11 Dhjetor 2023, në Shkodër,

- Edmir Abdija, shtetas shqiptare, lindur me 04.09.1989, në Shkodër, Shqipëri, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. Personal I90904072O, madhor , me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- Ingrid Perovic, shtetase shqiptare, lindur me 06.06.1975, në Shkodër, Shqipëri, mbajtëse e kartës së identitetit me Nr. Personal H55606059Q, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar


Vendosëm të nënshkruajmë këtë Statut, si mëposhtë, për krijimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës të rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe ky Statut.

Neni 1

Emri i Shoqërisë dhe Forma Ligjore

- 1.1 Në bazë e në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, themelohet Shoqëria “LAKEVIEW CABINS” SH.P.K., e ndjekur në mënyrë të pandashme nga shkurtimi “SH.P.K.”, e cila përfaqëson formën juridike të saj, të cilës këtej e tutje do ti referohemi si “Shoqëria”.
- 1.2 Shoqëria është një person juridik Shqiptar, që ka formen ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me Ligj Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
- 1.3 Shoqëria fiton personalitetin juridik nga momenti i regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), në përputhje me legjislacionin Shqiptar.
- 1.4 Ortakët e Shoqërisë gëzojnë përgjegjësi të kufizuar deri në kufirin e kontributeve përkatëse të tyre në kapitalin e përfaqësuar në kuota.
- 1.5 Në çdo dokument, fatura, shpallje apo publikime të bëra nga Shoqëria, pavarësisht nga mënyra e transmetimit, emri i Shoqërisë duhet të shoqërohet ose të ndiqet nga:
 - a. Fjalët “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” ose “SH.P.K.”
 - b. Numri unik i identifikimit (NIPT);
 - c. Selinë e regjistruar dhe zyrën qendrore
 - d. Të dhëna nëse Shoqëria është në proces likuidimi.

Edmir Abdija



Ingrid Perovic

Neni 2

Selia

Në momentin e miratimit të këtij statuti Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Rr. Lavrendit, Shiroke, Zona Kadastrale Nr. 8591, Nr. Pasurie 21/207-S1, Shkodër.

Shoqëria me vendim të Asamblesë së Përgjithshme mund të zhvendosë selinë e saj ose të krijojë një qendër operative në një vend tjetër në Republikën e Shqipërisë. Shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi në çdo vend, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, sipas gjykimit të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 3

Objekti i aktivitetit të Shoqërisë është:

Objekti i aktivitetit të Shoqërisë është:

Hoteleri;

Organizim grupesh turistike;

Neni 4

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar.

Neni 5

Ortakët

Në momentin e miratimit të këtij statuti ortakë të Shoqërisë janë:

- Edmir Abdija, me një kuotë dhe 50% të aksioneve
- Ingrid Perovic, me një kuotë dhe 50% të aksioneve.

Neni 6

Kapitali i Regjistruar

Vlera dhe pagesat e kapitalit të regjistruar

6.1 Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 500.000 leke, i ndarë në 2 kuota.

6.2 Kuota është e pjestueshme, e transferueshme, e trashëgueshme në përputhje me legjislacionin Shqiptar. Ajo transferohet në përputhje me Ligjin për shoqëritë dhe regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit si dhe në Librin e Ortakëve.

(1) Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 500.000 Lekë, i ndarë në 2 kuota.

(2) Aksionet në kapitalin e shoqërisë janë në përputhje me kontributin e zotëruesve të mëposhtëm:

Aksionari Edmir Abdija

Lloji i kontributit: Në para

Numri i kuotave: 1 kuotë

Vlera e kontributit: 250.000 Lek

Aksionari Ingrid Perovic

Lloji i kontributit: Në para

Numri i kuotave: 1 kuotë

Vlera e kontributit: 250.000 Lek

Edmir Abdija

Ingrid Perovic

Neni 7

Lënia dhe transferimi i pjesëve të kapitalit

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar duhet të bëhet me akt noterial.

Aksionet e shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre, mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë, në çastin e formimit të shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Neni 8

Struktura, organet drejtuese dhe administrimi i shoqërisë

Ortakët

Si organ i vetëm administrues, drejtues dhe përfaqësues i shoqërisë, sipas kërkesave ligjore, është asambleja e ortakëve.

Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:

- a) përcaktimin e politikave tregtare;
- b) ndryshime të statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- f) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
- g) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
- h) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
- i) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;
- j) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- k) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
- l) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.

Asambleja e përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e administrimit dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.

Nëse shoqëria zotërohet nga një aksionar, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga aksionari i vetëm.

Edmir Abdulla

Ingrid Perovic

Neni 9 Administratorët

Emërimi i Administratorëve

Zgjidhet si administrator i vetëm i shoqërisë z.Edmir Abdija, për një periudhë 5 vjeçare.

Kufizimet në lidhje me emërimin e Administratorëve parashikohen në pikën 2 të nenit 95 të Ligjit.

Administratorët e shoqërisë mund të rizgjidhen.

Kompetencat e Administratorëve

Politikat tregtare të shoqërisë do të administrohen nga Administratorët të cilët mund të ushtrojnë të gjithë kompetencat që nuk i rezervohen Ortakut sipas nenit 81 të Ligjit. Ndryshimet e statutit nga Ortakët dhe udhëzimet e Ortakëve nuk do të shfuqizojnë aktet e mëparshme të Administratorëve, të cilat do të ishin të vlefshme nëse ndryshimi nuk do të ishte kryer ose udhëzimi nuk do të ishte dhënë.

Administratorët nuk mund të delegojnë detyrimet e tyre ligjore.

Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorëve

Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

1. personi nuk është më Administrator sipas parashikimeve të Ligjit
2. personi ndodhet në gjendje paaftësie pagueuse;
3. personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
4. personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose
5. ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa arsye

Neni 10 Dividendët dhe Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Dividendët

(1) Pas plotësimit të parashikimeve të nenit 77 të Ligjit, shoqëria mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve përrputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

(2) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividendët deklarohet dhe paguhet në përrputhje me shumatat e paguara për kuotat për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhet në përrpjesëtim të drejtë me shumatat e paguara për kuotat, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividendi; në rast se kuota emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar dividendi do të paguhet në përrputhje me këtë kusht.

(3) Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuota nuk do të mbartë interesat ndaj shoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.

(4) Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset

nga Ortaku, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.

Neni 11

Prishja dhe njoftimet

Mbarimi

Shoqëria mbaron me vendim te ortakëve të shoqërisë ose kur ka një prishje të parakohshme për arsyet e parashikuara në ligj.

Likuidimi

Shoqëria hyn në proces likuidimi që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi Ortakët caktojnë një ose më shumë likuidatorë.

Në rast të likuidimit të Shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e posaçëm të Asamblesë Përgjithshme të marrë me shumicë të kualifikuar, mund të shpërndajë në dobi të aksionarëve të gjithë ose një pjesë vlerës së pasurive të Shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën shpërndarjes midis aksionarëve ose atyre që zotërojnë aksione të klasave të ndryshme të Shoqërisë.

Neni 12

Dispozita te fundit

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së Shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit do paraqiten për zgjidhje gjykatës kompetente shqiptare.

Shoqëria do të ketë vulën e saj, forma dhe madhësia e të cilës do të përcaktohen nga Ortakët.

ORTAKËT

Edmir Abdija

Ingrid Perovic